




ILIRJAN BEQIRI
EKSPozITË *exhibition*

 GALERIA
E MINISTRISË
SË KULTURËS

Prishtinë, 2004

KULLA SI MOTIV - OBJEKT TRAJTIMI

Tabllotë e prezantuara, kryesisht i takojnë ciklit të peizazheve dhe kullave asociative, apo siç i quan autori "kështjella të vogla vetëmbrojtjeje" të inkorporuara në hapësirën e gjerë të tabanit pollogian. Kulla si motiv trajtimi do t'i bëhet sinonim dhe lajtmotiv për çdo vepër që do të pasojë në vijimësi.

Duke i vëzhguar motivet e tabllave: istikamet, siluetat e kullave në koloritin flakërues të ngjyrave intensive, të shtëpive të djegura me theksim vertikal të oxhaqeve, të cilët i bënë ballë tërë asaj shtrëngate të kohës së brishtë, kohë e cila ia kishte kapluar shpirtin artistit, sikurse edhe shumë e shumë krijuesve të tjerë. Andaj, me ngulm e devocion të zjarrtë piktori i realizoi kompozimet: "Peizazh I", "Peizazh II", "Peizazh X" e kështu me radhë, duke e formësuar ciklin e tërësishëm të PEIZAZHEVE ASOCIATIVE NGA NËNËQIELLI I POLLOGUT me 20 tablo, me të cilat paraqitet para auditorit në hapësirën e galerisë "Qafa" të Ministrisë së Kulturës në Prishtinë. Të gjitha këto imazhe piktori në mënyrë imediate i përjetoi, jo vetëm në ambientin e vendlindjes së vet, në qytetin e Tetovës por edhe me ato ngjarje të një kohe më të hershme që u shfaqën në Kosovë.

Duhet thënë se piktori Ilirjan Beqiri që nga koha e studimeve në Fakultetin e Arteve si dhe në ato pas-diplomike me përkushtim i është qasur eksperimentimit të spektrit koloristik; të ngjyrave primare, intensive flakëruese, të cilat orvatet t'i harmonizojë jo vetëm me elementin e formës si tërësi kompozicionale por edhe me atë të vijës e cila çdo herë i qëndron në raport me dritën e plenerit natyral. Pra, në këtë trinomi figurative piktori orvatet që dufin e brendshëm ekspresiv ta shkrijë në telajon e strukturës fakturale kompozicionale.

Akordet e ngjyrës së verdhë me tërë atë vistër gradativ (shkallëzues) të tonaliteteve strukturale të fakturës pastuozë në tabllotë: "Peizazh XI", dhe "Peizazh XV", kundruadh raporteve të atyre të hirta në qiellin kolosal të shkrirë në tonalitete roze e oker shpreh një dramë të vërtetë piktoriale.

Në disa tablo të peizazheve asociative rrëzë malit të sharit venerrohen siluetat e rrënojave në hapësirën e thellë kompozicionale me shndërrim të formave natyrore në ato gjeometrike, me ç'rast piktori synon ta vënë në spikamë tërësinë e formës piktoriale, ta akcentojë konstruktin koloristik figurativ. Një vispamje e tillë kompozicionale e shndërrimit të formave natyrore, pa dyshim, se ka filluar me hulumtimet e para eksperimentuese shkencore të formave pleneriste të peizazheve dhe imazheve të shumta të Pol Sezanit.

Ndërkaq, ndërmarrjet hulumtuese të piktorit Beqiri në atë shndërrim të formave gjeometrike që në disa tablo spikasin përmes raporteve kontrastive të ngjyrave intensive, kryesisht synojnë që nga peizazhet e vendlindjes e deri në ato tablo të ciklit të fundit të titulluar "Peizazhe asociative të nënqiellit të Pollogut" t'i eksplokojë raportet kontrastive të ngjyrave primare intensive me ato neutrale në pjesën qiellore, gjithnjë duke u orvatur në spastrim të tërësisë strukturale koloristike. Me një spastrim të telajos fakturale mëton në një sintezë të tërësisë piktoriale.

Dr. Hivzi MUHARREMI

TOWER AS A MOTIVE - OBJECT OF APPROACH

The presented paintings, belong mainly to the panorama cycle and associative towers, or as called by the authors as "small self-defence towers" incorporated in the waste area of Polog outland. The tower as a motive of approach will become a synonym and light motive of every work that will precede in the future.

By watching the motives of the paintings: trenches, tower silhouettes in flammable colours of intensive colours, burned houses with vertical emphasize of chimneys, which resist all that fragile time storm, time which had grasped the artistic spirit, as the other artists. Therefore, perseveringly and with flaming devotion, the artist realized his compositions: "Panorama 1", "Panorama 2", "Panorama X" by forming the entire cycle of ASSOCIATIVE PANORAMAS FROM THE POLOG SKY with 20 paintings, in the gallery "Qafa" of the Ministry of Culture in Prishtina. All these images the artist experienced in an immediate way, not only in the hometown environment of Tetovo, but also from the earlier events that happened in Kosova.

It is important to say that the painter Ilirjan Beqiri, since the studies in the Faculty of Fine Arts, as well as in postgraduate studies, has been very persistent toward experimentation with the colour spectre; primary colours, flame intensive, with intention to harmonize not only with the forming element as a compositional wholeness but with that of the line, which every time stands in rapport with the light of natural plener. So, in this figurative trinomy the painter intends to melt his inner expressive attitude in that of a factorial compositional structure.

The yellow chords with all the gradation of the structural tonalities of pastors paintings "Panorama XI" and "Panorama XV", in contrast to their grey rapports in the colossal sky melted in rose and ochre tonalities show a real pictorial drama. In some paintings of associative panoramas beneath mountain Sharr some debris silhouettes are noticed in the deep composition area with a switch of those natural into geometric forms, which makes the painter put the wholeness of the picture form in the accent of the colour figurative construction. Such a compositional view of switching of the natural forms,

Undoubtedly, has started with the initiative experimental research of pleneriste forms of many panoramas of Pol Sezan. However, the research expeditions of Mr. Beqiri in turning of geometrical forms that in some paintings are shown through contrastive rapports of intensive colours, mainly derive from the hometown panorama to the final cycle named "Associative panoramas of Polog sky", where he tries to explicit the contrastive rapports of primary intensive colours with those neutral in sky part, always persisting on preserving the colour structure as a whole. With such persistence he reaches to a whole pictorial synthesis.

Dr. HIVZI MUHARREMI



Vaj në pëlhurë | *Oil on canvas* • 110 x 97 cm



Vaj në pelhurë | Oil on canvas · 93 x 80 cm



Vaj në pelhure | Oil on canvas · 80 x 71 cm



Vaj në pëlhurë | Oil on canvas · 66 x 56 cm




Vaj në pëlhurë | Oil on canvas · 65 x 56 cm



Vaj në pëlhurë | *Oil on canvas* · 87 x 71 cm



Vaj në pelhure | *Oil on canvas* • 113 x 100 cm



Vaj në pëlthure | *Oil on canvas* · 113 x 100 cm



Vaj në pëlhurë | *Oil on canvas* • 110 x 95 cm



Vaj në pëlhurë | Oil on canvas · 93 x 80 cm



Vaj në pëlhurë | Oil on canvas · 100 x 87 cm



Ilirjan Beqiri

I lindur më 1968 në Tetovë. Ka diplomuar më 1998 në Fakultetin e Arteve Figurative në Universitetin e Tetovës, drejtimi i Pikturës në klasën e profesor akademik Tahir Emra, ku kreu edhe studimet postdiplomike. Jeton dhe punon në Tetovë si profesor pranë Fakultetit të Arteve Figurative në Universitetin e Tetovës.

Born in 1968 in Tetovë - Republic of Macedonia. Graduated in 1998 at the Faculty of Arts of the University of Tetova, the Section Figurative Art in the class of Professor Ac. Tahir Emra, where he completed his postgraduate studies. Actually lives and works in Tetovë, and is a full time professor at the Faculty of Figurative Arts of the University of Tetova.

Adresa | Address:

B. Milladinovi 17, 1200 Tetovë

Tel.: +389 44 339 528

Mob.+389 70 371 442

Ekspozita personale | Personal Exhibitions

"Europe Gallery" Gostivar, 1998

Pallati i Kulturës, *City Hall* - Tetovë, 2003

Ekspozita kolektive | Collective Exhibitions

Është pjesëmarrës i të gjitha ekspozitave të Shoqatës së Artistëve Figurativë (SHAF) të Tetovës.

Pjesëmarrës në koloninë ndërkombëtare ARTIST'S WORKSHOP IN BERAT, 2001.

Po ashtu pjesëmarrës në Koloninë Ballkanike në Tetovë, më 2002.

He takes part in all exhibitions held and initiated by the Painter's Association (SHAF) based in Tetova.

He has taken part in the Painter's International Colony ARTIST'S WORKSHOP IN BERAT - R. of ALBANIA, in 2001.

He has taken part at the Balkan's Colony, held in Tetova, in 2002, as well.

